

RELACION

**Zhvillimi i dizajnit te detajuar te
brendshem per zyret e reja te
Qendres per Sherbime Arsimore**

Vendndodhja:
Rruga “Paskal Vodica”;
Kamëz, Tirane, Shqiperi

AUTORITETI KONTRAKTOR:
AADF

ATRIA STUDIO
NR.LIC. N.6853/2
ARK. ENOLA MARTOPULLO

Elma Hoxha
Frosiana Monçi
Leila Deliu
Pamela Hajdëraj

Permbajtja

HYRJE	4
Rreth AADF	4
Rreth Qendrës së Shërbimeve Arsimore.....	4
1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM	5
2. SFIDAT E GJENDJES EKZISTUESE	6
2.1 Organizimi i planimetrise	6
2.2 Lartësia e ulet e katit	6
2.3 Rrjeti i kolonave	7
2.4 Korridori i ngushte	7
2.5 Parapeti i jashtëm	7
2.6 Prezenca e lageshtise ne katin -1 dhe 0	7
2.7 Dyra e evakuimit ne katin -1	8
2.8 Dera ne anen e oborrit te brendshem	8
3.KONCEPTI	9
4.KATI 0	10
Gjendja ekzistuese e katit 0	10
Muratura qe do te priset	10
Muratura qe do te shtohet	11
Programi i katit per dhe	11
Plani i katit 0.....	12
5.KATI 1	13
Gjendja ekzistuese e katit 0	13
Muratura qe do te priset	13
Muratura qe do te shtohet	14
Programi i katit 1.....	14
Plani i katit 1.....	15
6. KATI 2	16
Gjendja ekzistuese e katit 2	16
Muratura qe do te priset	16
Muratura qe do te shtohet	17
Programi i katit 2.....	17
Plani i katit.....	18
7. MOBILIMI I BRENDSDHEM I HAPESIRAVE	20
KATI 0	20

RECEPSIONI DHE HAPESIRA E PRITJES	20
KATI 0	21
BAR KAFE	21
KATI 0,1	23
KLASAT E TESTIMIT DIGJITAL	23
KATI 0	24
AKSESI PER STAFIN	24
ZYRAT	25
KATI 2	28
KUZHINA.....	28
KATI 2	30
SALLA E MBLEDHJEVE	30

HYRJE

Rreth AADF

Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) është një organizatë jofitimprurëse e themeluar në vitin 2009 me mbështetjen e USAID dhe të qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Misioni i saj është të krijojë mundësi dhe të fuqizojë komunitetet përmes investimeve në arsim dhe lidërsip, sipërmarrje, trashëgimi kulturore dhe ekoturizëm. Në kuadër të programit të saj në arsim, AADF mbështet Ministrinë e Arsimit dhe Sportit si dhe QSHA-në në përpjekjet për të ofruar shërbime më cilësore.

Rreth Qendrës së Shërbimeve Arsimore

Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) është një institucion kombëtar me mandat të rëndësishëm në administrimin dhe mbikëqyrjen e një game të gjerë shërbimesh arsimore në Shqipëri. Ajo organizon dhe administron vlerësime kombëtare dhe ndërkombëtare, provime për licencim profesional, si dhe ofron shërbime për njohjen e diplomave, duke garantuar standarde të larta në çdo fazë të proceseve të vlerësimit dhe certifikimit.

Në bashkëpunim me institucione prestigjioze ndërkombëtare, QSHA synon përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit arsimor shqiptar dhe zbatimin e praktikave më të mira globale në fushën e vlerësimit dhe administrimit të shërbimeve arsimore. Njëkohësisht, institucioni luan një rol të rëndësishëm si partner i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe i Qeverisë së Shqipërisë në hartimin dhe zbatimin e politikave arsimore, duke ofruar të dhëna, analiza dhe ekspertizë të bazuara në proceset e vlerësimit.

Në kuadër të reformimit të institucionit, synohet transformimi i QSHA-së në një agjenci me standarde ndërkombëtare, me rol dhe përgjegjësi të rishikuara që pasqyrojnë rëndësinë e vlerësimit në zhvillimin e politikave arsimore. Analizat paraprake kanë evidentuar nevojën për rritjen e kapaciteteve njerëzore, modernizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës fizike, si elementë thelbësorë për rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Në këtë kontekst, ndërhyrja jonë projektuese synon të përkthejë këto nevoja në një zgjidhje të integruar arkitektonike dhe inxhinierike, duke u fokusuar në krijimin e një organizimi të qartë dhe fleksibël hapësinor, të përshtatshëm për kërkesat dinamike të institucionit. Përmes një gjuhe arkitektonike bashkëkohore dhe përdorimit të zgjidhjeve funksionale të menduara në detaj, projekti synon të përmirësojë cilësinë e ambienteve të punës, të nxisë bashkëpunimin ndërmjet përdoruesve dhe të krijojë kushte optimale për zhvillimin e aktiviteteve institucionale. Në tërësi, zgjidhjet e propozuara kontribuojnë në krijimin e një ambienti pune efikas, të qëndrueshëm dhe në përputhje me objektivat afatgjata të zhvillimit të QSHA-së.

1. PËRSHKRIMI PËRGJITHSHËM

Objekti ku do të zhvillohet ndërhyrja, ndodhet në qarkun e Tiranës, Kamëz, në kampusin universitar të Universitetit Bujqësor të Kamzës, përgjatë rrugës “Paskal Vodica”. Ndertesa është pjesë e kompleksit studentor dhe ndodhet në pjesën veriore të qytetit të Tiranës, rreth 10 km larg nga qendra e qytetit. Zona është lehtësisht e aksesueshme me automjet për rreth 20 minuta nga qendra e Tiranës, ose përmes linjave të transportit publik që lidhin qendrën e Tiranës me Kamzën.

Disa pika të rëndësishme pranë objektit ku do të zhvillohet ndërhyrja janë: Rektorati i Universitetit Bujqësor të Tiranës, godina e Fakultetit të Shkencave Bujqësore dhe Veterinare, Rezidencat Studentore si dhe Qendra Shëndetësore Universitare (QSHA).

Ndërtesat janë të organizuara rreth hapësirave të brendshme të gjelbëruara, të cilat krijojnë ambiente çlodhëse dhe nxisin ndërveprimin mes përdoruesve. Fasadat me dritare sigurojnë ndriçim natyral dhe ajrosje të mirë, ndërsa korridoret e hapura shtojnë ndjesinë e hapësirës dhe transparencës. I gjithë kompleksi është konceptuar për të ofruar komoditet, funksionalitet dhe një mjedis bashkëkohor. Kompleksi karakterizohet nga paleta shumëngjyrëshe e fasadave të godinave. (Fig 2).




Fig.1 Vëndndodhja e sheshit në raport me qendrën e qytetit




Fig.2 Godinat e kompleksit

2. SFIDAT E GJENDJES EKZISTUESE

Gjatë studimit dhe rilevimit të objektit të marrë në shqyrtim, u vunë re disa çështje për tu inspektuar. Godina ekzistuese paraqet disa problematika që lidhen me elementet konstruktive dhe tipologjinë e saj arkitektonike, pasi fillimisht është projektuar për të shërbyer si konvikt për studentët e Universitetit Bujqësor të Tiranës. Për shkak të këtij funksioni fillestar, objekti paraqet këto kufizime:

2.1 Organizimi i planimetrisë

Planimetria është konceptuar në mënyrë të tillë që në qendër të saj të pozicionohet një atrium, i cili organizon lëvizjen rreth e përqark tij dhe shërben si element shpërndarës i qarkullimit horizontal. Lidhja vertikale në godinë realizohet nëpërmjet dy grupeve shkallë-ashensor, të vendosura diagonalisht në cepat e objektit, përmes të cilave do të bëhet shpërndarja e përdoruesve.



Fig.3 Atriumi i godines

Në secilin kat, për shkak të gjerësisë së ngushtë të objektit dhe mënyrës së organizimit planimetrik, funksionet e reja aksesohen ose nga korridori i jashtëm, i cili lidh të gjitha ambientet, ose nga brendësia e objektit në mënyrë të njëpasnjëshme, ku kalimi nga një hapësirë në tjetrën realizohet drejtpërdrejt, pa praninë e një korridori të dedikuar. Kësisoj, tipologjia aktuale e organizimit hapësinor, e kombinuar me gjerësinë e kufizuar të godinës, e bën të vështirë krijimin e një korridori qendror në planimetri që do të siguronte akses të drejtpërdrejtë dhe funksional drejt ambienteve të shërbimit. (Fig 3).

2.2 Lartësia e ulet e katit

Nga rilevimet e kryera në objektin ekzistues, lartësia dysHEME-tavan rezulton 273 cm, vlerë kjo jo shumë e favorshme për një perjetim të interierit. Duke qenë se sistemi i impianteve aktualisht nuk është i instaluar, pas projektimit dhe integritetit të tij pritet që kjo lartësi të reduktohet edhe më tej, duke kufizuar ndjeshëm fleksibilitetin në organizimin dhe trajtimin hapësinor të ambienteve. Si rrjedhojë, vendosja e një tavani të varur nuk konsiderohet një zgjidhje e përshtatshme në këto kushte, pasi do të ulte më tej lartësinë e dobishme të hapësirës.



Fig.4 Vendosja e kolonave

2.3 Rrjeti i kolonave

Rrjeti i kolonave në objekt është i pozicionuar kryesisht përgjatë mureve të jashtme, megjithatë përgjatë brinjës së gjatë të godinës zhvillohet një aks kolonash i vendosur brenda hapësirës së interierit. Pozicionimi i tyre jo i favorshëm në raport me gjerësinë terthore të objektit dhe dimensionimi i këtyre elementeve strukturore ndikon drejtpërdrejt në organizimin e funksioneve të reja, duke kufizuar mundësitë e ndarjeve planimetrike dhe fleksibilitetin e përdorimit. Disa prej kolonave janë të vendosura pingul me drejtimin e mureve. Njëkohësisht, prania e tyre redukton gjerësinë efektive të objektit me thellësinë e kolonave, duke ndikuar ndjeshëm në cilësinë hapësimore, veçanërisht në ambientet që kërkojnë perceptim maksimal të hapësirës dhe vazhdimësi vizuale. (Fig 4).



Fig. 5 Gjerësia e korridorit me një person reference

2.4 Korridori i ngushtë

Korridori i jashtëm, i cili zhvillohet përgjatë atriumit, mundëson një qarkullim 360° brenda objektit, duke e bërë atë itinerarin kryesor për lëvizjen nga një pikë në tjetrën të godinës. Megjithatë, sipas kushteve standarde të projektimit, gjerësia ekzistuese e këtij korridori nuk përmbush kriteret për kalimin komod të dy individëve, veçanërisht në situata fluksi apo përdorimi të shtuar. Gjithashtu, xokoli i vogël që shtrihet përgjatë gjithë gjatësisë së korridorit redukton më tej gjerësinë efektive të tij, duke ndikuar ndjeshëm në funksionalitetin dhe komoditetin e lëvizjes. (Fig 5).



Fig. 6 Parapeti i korridorit të jashtëm

2.5 Parapeti i jashtëm

Parapetet e vendosura në korridorin e jashtëm janë realizuar me material metalik dhe kanë një lartësi prej 130 cm. Këto elemente janë të fiksuara me soletën e korridorit nëpërmjet bulonave lidhëse. Nga verifikimi në terren, këto parapete kanë nevojë për shtimin e strukturave fiksuese të tilla si ato ekzistuese. Kësisoj, rritet siguria dhe qendrueshmeria e tij me kalimin e kohës. (Fig 6)

2.6 Prezenca e lageshtisë në katin -1 dhe 0

Gjatë vizitës në terren është konstatuar se në katet përdhe, konkretisht në katin -1 dhe në katin 0, evidentohet prezencë e gjurmëve të lagështisë në

mure dhe në kolona. Kjo situatë është gjykuar si pasoje e një grumbullimi të ujrave, tharjes dhe perthithjes së tyre nga muret në një kohë të pacaktuar. Kjo problematikë mund të lidhet me nivelin e ujërave nëntokësorë, si edhe me infiltrimin e ujërave të shiut, duke sugjeruar një drenazhim joefektiv të largimit të tyre nga perimetri i godinës. (Fig 7).

2.7 Dyra e evakuimit në katin -1

Në godinë, ndodhet një derë evakuimi e cila hapet nga brenda drejt grupit shkallë-ashensor, çka mund të mos përputhet me kërkesat bashkëkohore të sigurisë. (Fig 7).

2.8 Dera në anën e oborrit të brendshëm

Aktualisht paraqitet një problem në funksionimin e derës së hyrjes për shkak të një disnivele ndërmjet kuotës së plansistemimit të jashtëm dhe kuotës së dyshemesë së brendshme të objektit. Disnivele ekzistues është rreth 30 cm, çka pengon hapjen normale të derës.

Për të mundur funksionimin korrekt të derës, është e nevojshme që kuota e sistemimit të jashtëm të unifikohet me kuotën e nivelit të brendshëm të ndërtesës. Kjo nënkupton që kuota e sistemimit duhet të përshtatet në të njëjtin nivel me planin e brendshëm të objektit. (Fig. 8)




Fig. 7 Pamje e brendshme e godinës





Fig. 8 Pamje e derës në nivelin e plansistemimit

3.KONCEPTI


Konceptimi i interiorit është menduar për të krijuar një ambient funksional, modern dhe komod, i përshtatur si për punë të përditshme ashtu edhe për zhvillimin e proceseve të testimit në kushte optimale. Organizimi i hapësirave është realizuar në mënyrë të tillë që të sigurojë qartësi në lëvizje, ndarje efikase të funksioneve dhe një eksperiencë sa më të thjeshtë për përdoruesit. Paleta shumëngjyrëshe është përzgjedhur me kujdes për të krijuar një atmosferë të gjallë dhe pozitive, duke ndikuar drejtpërdrejt në mirëqenien emocionale të individëve, në uljen e stresit gjatë provimeve dhe në rritjen e përqendrimit. Njëkohësisht, përdorimi i ngjyrave shërben si element orientues vizual, duke lehtësuar navigimin në ambient dhe identifikimin e zonave të ndryshme funksionale.




Përzgjedhja e kësaj palete është e frymëzuar nga tonalitetet e fasadave ekzistuese të ndërtesave në kompleks, duke synuar krijimin e një vazhdimësie estetike dhe harmonie me kontekstin përreth. Kjo qasje kontribuon në integrimin e godinës brenda identitetit të përgjithshëm arkitektonik të zonës. Mobilimi karakterizohet nga forma moderne dhe minimaliste, të cilat jo vetëm që përforcojnë pastërtinë vizuale të hapësirës, por gjithashtu garantojnë ergonomi, fleksibilitet dhe lehtësi në riorganizim sipas nevojave të ndryshme funksionale. Materialet e përzgjedhura janë të qëndrueshme dhe praktike për përdorim intensiv, duke ruajtur njëkohësisht një estetikë bashkëkohore. Në këtë mënyrë, ngjyrat dhe dizajni i mobiljeve ndërthuren për të krijuar një identitet të qartë dhe një përjetim të balancuar, profesional dhe mikpritës të interiorit të godinës.




Gjendja ekzistuese e katit 0




Muratura qe do te prishet perfshin muraturen e tualeteve dhe nje pjese te pareteve vertikale nga ku do te mundesohet kalimi ndermjet ambienteve.



Muratura qe do te shtohet perfshin nje rinovim planimetrik te nyjeve higjenosanitare dhe shtimin e mureve te gipsit.



Programi i katit perdhe



Siperfaqja e ekzaminimit
dixhital



Dhomë per monitorim



Hapesirë për hollin
200 persona
Kerkon hapësirë për një holl



Dhoma e Shumfshimit të
provimeve dhe dhoma e
magazinit



Nyje higjeno-sanitare

Sipas programit të ndarjes së hapësirave, në katin perdhe (K0, +0.00) të godinës janë të organizuara një sërë hapësirash funksionale që mbulojnë nevojat e përdoruesve dhe stafit. Në këtë nivel ndodhen recepsioni dhe hapësira pritjeje, të cilat ofrojnë një mirëseardhje dhe orientim të qartë për vizitorët. Në shërbim të njerëzve, ofrohen hapësira për lexim, një kafe dhe një bar. Studentët që vijnë mund të depozitojnë sendet personale në dollapët me çelës. Monitorimi i aktiviteteve sigurohet përmes një zone të dedikuar, ndërsa klasat për testim dixhital janë të pajisura për kapacitete të ndryshme: përkatësisht për 35 dhe 37 persona. Hapësirat sanitare përfshijnë tualete për femra, meshkuj dhe për personat me aftësi të kufizuara të cilat janë të pozicionuara diagonalisht në raport me aksin kryesor të hapësirës. Lidhja vertikale sigurohet nga grupi i shkallëve dhe ashensori, ndërsa proceset e administrimit dhe testimi zhvillohen në hapësirat për shumëfishimin e provimeve dhe magazinimi i tyre.




Plani i katit 0

LEGJENDE


- | | |
|----------------------------|---|
| 1.Reception | d.Klasë për 53 persona |
| 2.Hapësirë pritjeje | e.Klasë për 38 persona |
| 3.Hapësirë për lexim | 9.Tualet për femra |
| 4.Kafe | 10.Tualet për njerëzit me aftësi të kufizuara |
| 5.Bar | 11.Tualet për meshkuj |
| 6.Depo në shërbim të barit | 12.Grupi shkallë/ashensor |
| 7.Monitorim | 13.Hapësirë për shumëfishimin e provimeve |
| 8.Klasa testimi dixhitale | 14.Magazinimi i provimeve |
| a.Klasë për 35 persona | 15.Dollapë me çelës |
| b.Klasë për 37 persona | |
| c.Klasë për 50 persona | |

5.KATI 1


Gjendja ekzistuese e katit 0



Muratura qe do te priset perfshin muraturen e tualeteve dhe nje pjese te pareteve vertikale nga ku do te mundesohet kalimi ndermjet ambienteve.




Muratura qe do te shtohet perfshin nje rinovim planimetrik te nyjeve higjenosanitare dhe shtimin e mureve te gipsit per hapësirat e zyrave dhe dhomave te monitorimit.




Programi i katit 1

Katin 1, ne kuoten +3.15 e zënë kryesisht hapësirat e dedikuara për testimin dixhital dhe administrimin e provimeve. Aty ndodhen monitorimi i klasave dixhitale për 50, 53 dhe 38 persona, si dhe një hapësirë pritjeje për studentët. Në këtë kat, ndodhet Drejtoria e Provimit Shtetëror, e ndarë në Zyrën të Drejtorit, Sektorin e Administrimit të Provimeve të Profesioneve të Rregulluara me 8 specialistë dhe një shef sektori, si dhe Sektorin e Administrimit të Bankës së Testeve dhe Standardizimit me 6 specialistë dhe një shef sektori. Gjithashtu, janë parashikuar një dhomë e qetë për takime online dhe një stacion printimi, duke siguruar organizim efikas dhe funksional të proceseve administrative dhe mësimore.



Plani i katit 1



LEGJENDE

7. Monitorimi i klasave dixhitale

8. Klasa testimi dixhitale

a. Klasë për 35 persona

b. Klasë për 37 persona

c. Klasë për 50 persona

d. Klasë për 53 persona

e. Klasë për 38 persona

9. Tualet për femra

10. Tualet për njerëzit me aftësi të kufizuara

11. Tualet për meshkuj

12. Grupi shkallë/ashensor

17. Hapësire pritjeje për klasat dixhitale

a. Drejtoria e provimit shtetëror

18a. Zyra e Drejtorit

19a. Sektori i Administrimit të Provimeve të Profesioneve të Rregulluara

- 8 Specialiste dhe 1 Shef Sektori

20a. Sektori i Administrimit të Bankës së Testeve dhe Standardizimit


- 6 Specialiste dhe 1 Shef Sektori

22a. Dhomë e qetë (Takime online)


23a. Stacion printimi

6. KATI 2


Gjendja ekzistuese e katit 2



Muratura qe do te prishet perfshin muraturen e tualeteve dhe nje pjese te pareteve vertikale nga ku do te mundesohet kalimi ndermjet ambienteve.



Muratura qe do te shtohet perfshin nje rinovim planimetrik te nyjeve higjenosanitare dhe shtimin e mureve te gipsit per hapësirat e zyrave, kuzhines dhe arkives si dhe shtimin e vetratave te xhamit ne korridorin e zyrave dhe sallën e mbledhjes.



Programi i katit 2

Ne katin e dyte, ne kuoten +6.30, hapësirat janë konceptuar për të garantuar një rrjedhë efikase të punës, duke përfshirë ambiente shërbimi si tualetet për femra, meshkuj dhe persona me aftësi të kufizuara, grupin e shkallëve dhe ashensorit, si dhe hapësira pritjeje të dedikuara për përdoruesit dhe klasat dixhitale. Njëkohësisht, janë parashikuar ambiente mbështetëse si kuzhina/kafeteria, arkiva me siguri të lartë, ambientet teknike dhe zyra për funksione specifike administrative dhe protokollare. Në nivel drejtues, godina përfshin zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm, zyrat e nëndrejtorëve dhe salla mbledhjesh fleksibël që mund të bashkohen sipas nevojës.


Ambienti i arkivës është projektuar si një hapësirë e dedikuar për ruajtjen afatgjatë të dokumentacionit fizik dhe materialeve arkivore në letër, të sistemuara në rafte metalike. Për shkak të rëndësisë së materialeve të ruajtura, arkiva është konceptuar si një ambient i izoluar, me elementë ndërtimorë që rrisin nivelin e mbrojtjes ndaj zjarrit.


Muret rrethuese janë realizuar prej betoni, duke siguruar rezistencë të lartë ndaj zjarrit dhe duke kufizuar përhapjen e flakëve dhe temperaturës drejt ambienteve përreth. Hyrja në arkivë realizohet nëpërmjet një dore hermetike dhe të automatizuar, e integruar me sistemin e mbrojtjes nga zjarri. Në rast alarmi, dera mbyllet automatikisht pas një kohe të shkurtër vonese që lejon evakuimin e personave, duke izoluar plotësisht ambientin dhe duke krijuar kushtet e nevojshme për funksionimin efektiv të sistemit të fikjes së zjarrit.

Kjo zgjidhje siguron mbrojtjen e dokumentacionit arkivor, ruan integritetin e hapësirës gjatë një emergjence dhe garanton funksionimin e koordinuar të elementeve të sigurisë së ndërtesës.

Struktura organizative reflektohet qartë në ndarjen sipas drejtorive kryesore, si Drejtoria e Vlerësimit të Performancës dhe Arritjeve Arsimore, Drejtoria e Shërbimeve Arsimore dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, secila e pajisur me zyra drejtuese, sektorë funksionalë dhe staf specialistësh të dedikuar. Gjithashtu, janë integruar hapësira bashkëkohore si dhoma të qeta për takime online dhe stacione printimi, të cilat mbështesin proceset administrative dhe teknologjike të institucionit. Ky organizim synon të krijojë një mjedis pune të strukturuar, efikas dhe të përshtatshëm për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve institucionale.

Plani i katit 2





LEGJENDE

9. Tualet për femra
10. Tualet për njerëzit me aftësi të kufizuara
11. Tualet për meshkuj
12. Grupi shkallë/ashensor
17. Hapesire pritjeje për klasat dixhitale
24. Kuzhina/ Kafeteria
25. Arkiva e sigurisë së lartë për institucionin
26. Kabinë zyre për personin përgjegjës për protokollin
27. Ambient Teknik
28. Zyra e Drejtorit të përgjithshëm
29. Zyra e dy nëndrejtorëve
30. Salle mbledhje
- (2 salla të cilat mund të bashkohen në një të vetme)
31. Hapesire pritjeje

b. Drejtoria e Vlerësimit të Performancës dhe Arritjeve Arsimore

18b. Zyra e Drejtorit

19b.

1. Sektori i regjistrimit për studentët
- 8 Specialistë dhe 1 Shef sektor
2. Sektori i Administrimit të Provimeve
- (4 specialistë + 1 shef sektor)

20b.

1. Sketori i njohjes së diplomës Universitare dhe sektori i Certifikatës
- 6 specialistë dhe 1 Shef Sektori
2. Sektori i Vlerësimit dhe Arritjeve Kombëtare
- 7 specialistë dhe 1 Shef Sektori

21b.

1. Sketori i njohjes së diplomës Universitare dhe sektori i Certifikatës
- 6 Specialistë dhe 1 Shef sektor

2. Sektori i Vlerësimit dhe Arritjeve Kombëtare

- 7 specialistë dhe 1 Shef Sektori

22b. Dhomë e qetë (Takime online)

23b. Stacion printimi

c. Drejtoria e Shërbimeve Arsimore

18c. Zyra e Drejtorit

19c. Sektori i regjistrimit për studentët
- 8 Specialistë dhe 1 Shef sektor

20c. Sketori i njohjes së diplomës para Universitare dhe Sektori i Certifikatës
- 5 Specialistë dhe 1 shef sektor

21c. Sketori i njohjes së diplomës Universitare dhe sektori i Certifikatës
- 3 Specialistë dhe 1 Shef sektor

22c. Dhomë e qetë (Takime online)


23c. Stacion printimi

d. Drejtoria e Finances dhe Shërbimit suportues

KATI 0

BAR KAFE


Rafti me ngjyrë të kuqe (RAL 3001) paraqet një element funksional dhe vizualisht tërheqës në ambient. I konceptuar për të krijuar një hapësirë kalimi, ai shërben si ndarës praktik pa penguar qarkullimin. Dizajni përfshin seksione të hapura nga të dyja anët, duke mundësuar akses të lehtë dhe përdorim nga të dy drejtimet, si dhe pjesë të hapura vetëm nga njëra anë për organizim më të strukturuar. Ky kombinim e bën raftin të përshtatshëm si për ekspozim, ashtu edhe për depozitim.





Tavolina e barit të kafesë është konceptuar në formë modulare, duke ofruar fleksibilitet dhe përshtatje të lehtë në ambient. E realizuar me material MDF të lyer në ngjyrë të bardhë, ajo paraqet një pamje të pastër dhe moderne, e cila harmonizohet lehtësisht me hapësirën përreth.

Element dekorativ përbën vazoja e luleve, e integruar në strukturë dhe e realizuar gjithashtu me MDF të lyer në një nuancë të verdhë, duke shtuar kontrast dhe një prekje të gjallë në dizajn. Ky kombinim e bën tavolinën funksionale dhe njëkohësisht tërheqëse për ambientet e kafesë.



KATI 0,1


KLASAT E TESTIMIT DIGJITAL




Tavolina e klasës së testimit digjital karakterizohet nga një dizajn minimalist me linja të pastra, duke krijuar një ambient të rregullt dhe të fokusuar për punë. Ajo është e organizuar në kabina individuale me ndarëse, të cilat sigurojnë privatësi dhe minimizojnë shpërqendrimet gjatë procesit të testimit.

Çdo tavolinë është e pajisur me kompjuter dhe njësinë qendrore përkatëse, duke garantuar funksionalitet të plotë për çdo përdorues. Struktura ofron hapësirë të dedikuar për vendosjen e pajisjeve të punës, duke siguruar komoditet dhe organizim optimal.

Kombinimi i ngjyrës së bardhë me blu të çelët i jep ambientit një pamje të freskët dhe moderne, duke ndikuar pozitivisht në përqendrim dhe produktivitet.







KATI 0

AKSESI PER STAFIN

Në aksin e dedikuar për stafin, i pozicionuar në mes të korridorit hyrës, është vendosur një ndenjësë në formë trekëndore që shërben si element funksional dhe orientues në hapësirë. Dizajni i saj i veçantë kontribuon në organizimin e rrjedhës së lëvizjes, duke krijuar një pikë ndalese të rehatshme dhe praktike. Ndenjësja është e realizuar me material MDF me imitim druri në ngjyrë gri, duke ofruar një pamje moderne dhe të qëndrueshme. Element plotësues është vazoja e luleve, e integruar në të njëjtin material dhe ngjyrë, e cila shton një prekje natyrale dhe e bën ambientin më mikpritës dhe estetikisht të balancuar.




KATI 2

ZYRAT



Ne ambientin ezyrave te hapura, jane percaktuar disa module tavolinash sipas departamenteve dhe ndarjes se punonjesve. Ne nje model tavoline, tavolina është konceptuar si një strukturë drejtkëndore me një cep gjysmë harku në njërin anë, ku gjendet një vazo lulesh dekorative, që i jep një prekje natyrale dhe estetike ambientit të zyrës dhe gjithashtu ben nje ndarje privatesie mes hapësires se punes dhe asaj qarkulluese. Keshtu ndiqet llogjika e mobiljes se ulese ne reception.

Tavolina është e dizajnuar për të akomoduar deri në 6 persona, me hapësira të përcaktuara individuale për secilin përdorues, të pajisur me kompjuterë në secilin stacion pune, për të mundësuar punë efikase dhe bashkëpunuese.



PAMJA PLANARE

Technical drawing of a planar bench (PAMJA PLANARE) showing top and side views with dimensions and material specifications.

Top View Dimensions:

- Overall length: 110
- Overall width: 300
- Segment lengths (from left to right): 40, 45, 25, 2, 51, 15, 51, 2, 51, 15, 51, 2, 51, 15, 51, 2

Side View Dimensions:

- Overall height: 105
- Segment heights (from bottom to top): 40, 45, 25, 2, 51, 15, 51, 2, 51, 15, 51, 2, 51, 15, 51, 2

Material Specifications:

- Material MDF - RAL 0000
- Vazo lule material MDF vâlm dur, ngjyrë gri (ë shikohet katalogu).
- Këmbë metalike
- Material MDF - RAL 5004
- Profile metalike
- Këmbë metalike
- Hapësirë e dedikuar për njësinë qendrore

PAMJA A-A

Vazo kule
- material MDF
- imit. drui,
- ngjyrë gri
(shikohet katalogu).

Material MDF
- RAL 5024

PAMJA B-B

Material MDF
- RAL 5024

Vazo kule
- material MDF
- imit. drui,
- ngjyrë gri
(shikohet katalogu).

Këmbë
metalike

Material MDF
- RAL 5024

Material/MDF
- RAL 5024

Këmbë
metalike

Hapësirë e
dedikuar
për pajisje
qendrore


PAMJA A'-A'

Material MDF
- RAL 5024


Këmbë
metalike




PAMJA PLANARE



PAMJA A-A



PAMJA B-B




KATI 2

KUZHINA




Kuzhina është projektuar në funksion të nevojave të punonjësve, duke ofruar të gjitha pajisjet e domosdoshme për një pushim të organizuar dhe efikas. Mobilimi i kuzhinës përfshin pajisje si mikrovalë dhe makineri kafeje, si dhe është i pajisur me hapësira të mjaftueshme depozitimi për organizim optimal.





Hapësira e kuzhinës është dimensionuar për të akomoduar deri në 45 persona, të cilët janë të shpërndarë në tavolina të ndryshme me kapacitete të ndryshme uljeje, duke mundësuar fleksibilitet dhe komoditet në përdorim.

Tavolina është trajtuar me ngjyrë blu e hapur, duke u integruar në mënyrë harmonike me ambientin e kuzhinës. Në strukturën e saj janë të integruara vazo lulesh, të vendosura përgjatë aksit të tavolinës, të cilat shërbejnë si element dekorativ dhe kontribuojnë në krijimin e një ambienti më të këndshëm dhe relaksues gjatë kohës së pushimit.



KATI 2

SALLA E MBLEDHJEVE



Salla e mbledhjeve është konceptuar për të ofruar fleksibilitet të lartë në përdorim, i cili realizohet përmes sistemit të vetratave me palosje, që mundësojnë hapjen dhe mbylljen e hapësirës në varësi të numrit të pjesëmarrësve në mbledhje.

Gjithashtu, tavolinat modulare janë projektuar për t'u lidhur dhe kombinuar me njëra-tjetrën në forma të ndryshme, duke krijuar konfigurime të ndryshme sipas nevojës dhe duke maksimizuar në këtë mënyrë shfrytëzimin e hapësirës.

